VENDIM
Nr.251, datë 27.2.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA GRESHICË TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Greshicë të qarkut të Fierit, që do t'i transferohen në pronësi kësaj njësie.
2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 9 (nëntë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Greshicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta të tipit, pyje, kullota, livadhe, shkëmbor etj.)

Institucioni i pushtetit qendror Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave Komuna: Greshicë										
Nr.	Nr. i INV sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore/ kullosore	Emërtesa e ngastrës vendodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacion	Sip. në ha	Funksioni për të cilën përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucione/ enti përdorues	Të dhëna të tjera Shënime të veçanta
1.	39	Ek. Pyjore Povel	Pylli i Piraves	7/a	Pyll	33.5	Mbrojtës	MMPAU	DSHP Mallakastër	
2.	40	Ek. Pyjore Povel	Pylli i Piraves	7/b	Pyll	7.25	Mbrojtës	MMPAU	DSHP Mallakastër	
3.	41	Ek. Pyjore Povel	Pylli i Piraves	8/a	Pyll	5	Mbrojtës	MMPAU	DSHP Mallakastër	
4.	42	Ek. Pyjore Povel	Pylli i Piraves	8/b	Pyll	4	Prodhues	MMPAU	DSHP Mallakastër	
5.	43	Ek. Pyjore Povel	Pylli i Sollakut	8/c	Pyll	6.25	Prodhues	MMPAU	DSHP Mallakastër	
6.	44	Ek. Pyjore Povel	Pylli i Greshicës	8/d	Pyll	2	Prodhues	MMPAU	DSHP Mallakastër	
7.	45	Ek. Pyjore Povel	Pylli i Sollakut	8/e	Pyll	7	Prodhues	MMPAU	DSHP Mallakastër	
8.	46	Ek.Pyjore Povel	Pylli i Greshhicës	8/f	Pyll	2	Prodhues	MMPAU	DSHP Mallakastër	
9.	47	Ek. Pyjore Povel	Shendelli	9	Pyll	6	Prodhues	MMPAU	DSHP Mallakastër	

Njësia e qeverisjes vendore, komuna Greshicë Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
39-47	Pyll	Pronësi